



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 3 pika (ç) të Rregullores nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh Memorandumin e Mirëkuptimit të muajit tetor 2003 si dhe vendimin e Qeverisë të datës 10.09.2003,

Me qëllim të sigurimit të një mirëqenie sociale më të favorshme për punëtorët e kompleksit “Trepça” dhe minierat e tjera më mihe nëntokësore, **Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:**

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 10/2007
PËR
PENSIONIM TË PARAKOHSHËM PËR
PUNËTORËT E KOMPLEKSIT “TREPÇA” NËN ADMINISTRIMIN E UNMIK-ut
DHE MINIERAVE ME MIHJE NËNTOKËSORE NË KOSOVË**

**Neni 1
Qëllimi i Udhëzimit Administrativ**

(1) Nxjerrja e këtij Udhëzimi Administrativ, ka për qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve si dhe rregullimin e procedurave dhe rregullave tjera për realizimin e pensioneve të parakohshme për punëtorët e kompleksit “Trepça” dhe minierat e tjera me mihe nëntokësore.

Neni 2

Kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin e pensionit të parakohshëm

(1) Përfitues të këtij pensioni të parakohshëm janë të gjithë punëtorët e kompleksit “Trepça” nën administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore, të cilët i plotësojnë këto kushte dhe kriteret:

1. Të jenë në moshën 50-65 vjeçare,
2. Punëtorët e punësuar në minierë tek të cilët paraqitet paaftësia për punë (invaliditeti) për shkak të ndryshimeve në gjendjen e tyre shëndetësore, ndryshime të cilat nuk mund të kurohen me mjekim të mëtejshëm, dhe aftësia e tyre për punë është zvogëluar më shumë se përgjysmë.
3. Të kenë dhjetë (10) apo më shumë vite përvojë punë në kompleksin “Trepça” apo miniera të tjera,
4. Të jenë banorë të përhershëm të Kosovës,
5. Të mos jenë përfitues të asnjë skeme tjetër të financuar dhe të paguar nga Buxheti i Kosovës,
6. Të mos realizojnë të ardhura të tjera nga punësimi i rregullt në Kosovë apo jashtë saj, por edhe të çfarëdo forme tjetër të vetëpunësimit,
7. Të kenë shkëputje të kontratës së punës në kompleksin “Trepça” dhe minierat e tjera si dhe heqja dorë nga beneficionet ose pagesat e mëtejme nga punëdhënësi.
8. Personalisht duhet të bëjnë tërheqjen e pensionit të parakohshëm nga kontoja e bankës përkatëse,
9. Të argumentojnë aftësinë e kufizuar të punës me prezantimin e vlerësimit nga Komisioni Mjekësor i Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës që vepron në kuadër të MPMS-së.

(2) Personat që nuk i përmbushin këto kushte dhe kriteret në datën e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, do ta fitojnë të drejtën kur t'i përmbushin kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes.

Neni 3

Procedurat e aplikimit për pension të parakohshëm

(1) Secili punëtor i kompleksit “Trepça” dhe minierave me mihje nëntokësore në Kosovë, nëse i plotëson kushtet dhe kriteret për pension të parakohshëm sipas nenit paraprak, duhet të parashtrijë kërkesë në Menaxhmentin e kompleksit “Trepça”.

(2) Menaxhmenti i kompleksit “Trepça” në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Udhëzim Administrativ, e bën përzgjedhjen e shfrytëzuesve të pensioneve të parakohshme.

(3) Menaxhmenti i kompleksit “Trepça”, për personat e përzgjedhur përpilon regjistrin e shfrytëzuesve të këtyre pensioneve, të cilin në afatin e paraparë ia procedon Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës që vepron në kuadër të MPMS-së.

(4) Asnjë person nuk mund të shtohet në regjistrimin e personave të përzgjedhur gjatë kohëzgjatjes së këtij programi, nëse nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara më këtë Udhëzim Administrativ.

(5) Regjistri i personave të përzgjedhur si shfrytëzues të pensioneve të parakohshme duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e shfrytëzuesit të pensionit, datëlindjen e tij, adresën e saktë të vendbanimit dhe letërnjoftimin e UNMIK-ut.

Neni 4

Procedurat e administrimit të pensioneve të parakohshme.

(1) Pas pranimit të kërkesave të aplikuesve për pension të parakohshëm, menaxhmenti i kompleksit “Trepça”, obligohet që dosjet e kompletuara për secilin parashtrues së kërkesës së pensionit të parakohshëm, ti procedoj për administrimin dhe verifikim të mëtejme në Qendrat Rajonale të DAPK-së në Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan dhe qendrat tjera eventuale me kompetencë.

(2) Për procedimin dhe dorëzimin e dosjeve të shfrytëzuesve të pensioneve të parakohshëm, në Qendrat Rajonale të DAPK-së të MPMS-së, që nga fillimi kësaj skeme pensionale e deri me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ. MPMS dhe menaxhmeti i “Trepçës “ do të formojnë një komision të përbashkët i cili do të përkujdeset për procedurat e klasifikimit, sistemimit, regjistrimit dhe transportimin e dosjeve në Qendrat rajonale të DAPK-së në përputhje me Ligjin për arkivin dhe lëndët arkivore të Kosovës .

(3) Dinamika e kryerjes së punëve të procedimit të dosjeve të mëhershme në Qendrat Rajonale të DAPK-së nga administrata e kompleksit “Trepça”, është 15 ditë pune nga dita e formimit të komisionit të përbashkët të dy institucioneve.

Neni 5

Burimet financiare për pensionet e parakohshme

(1) Qeveria e Kosovës do t’i financojë pensionet e parakohshme duke bërë transferim mujor të parave nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në njërën nga bankat komerciale, në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit.

(2) Për realizimin efikas dhe të suksesshëm të skemës së pensioneve të parakohshme, Menaxhmenti i kompleksit “Trepça” për çdo ndryshim të situatës, duhet të informojë Departamentin e Administratës Pensionale të Kosovës që vepron në kuadër të MPMS-së.

(3) Pagesat e pensioneve të parakohshme do t’u nënshtrohen kontrolleve financiare sipas rregullave të zbatueshme për shpenzimet e buxhetore.

Neni 6

Pagesat e pensioneve të parakohshme

(1) Pensioni i parakohshëm paguhet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, prandaj ky beneficion i përkohshëm është paraparë për shkak të pamundësisë së angazhimit të punëtorëve të Trepçës në punë, e jo në bazë të punës së kaluar.

(2) Lartësia mujore e shumës së pensionit të parakohshëm është 50€(euro).

(3) Këto pagesa të pensionit të parakohshëm do të administrohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

(4) Pagesat e pensioneve të parakohshme do të jenë mujore dhe shpërndarja e mjeteve bëhet përmes Bankës së autorizuar ku pensionistët i kanë llogaritë individuale. Këto pensione do të paguhen në këto shuma deri në rregullimin e kësaj çështjeje me akt tjetër ligjor apo nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria apo Kuvendi i Kosovës.

Neni 7

Përgjegjësitë për verifikimin e pensioneve të parakohshme

(1) Autoritetin verifikues të të dhënave të paraqitura nga ana e Menaxhmentit “Trepça” dhe minierave më mihje nëntokësore për përfituesit e parakohshëm të pensioneve e kanë zyrtarët e DAPK-së, përkatësisht zyrtarët e Zyrës Rajonale përkatëse të DAPK-së.

(2) Bankat komerciale obligohen që për ecurinë e pagesës së pensioneve të parakohshme të raportojnë në formë të shkruar deri më datën 15 të muajit vijues.

Neni 8

Fshirja nga regjistri i përfitueseve të pensioneve të parakohshme

(1) Përfituesi i pensionit të parakohshëm i cili nuk e tërheq pensionin në afat prej 15-30 ditësh, pensioni do të rikthehet në llogari të Ministrisë.

(2) Përfituesi i pensionit i cili (tre muaj) nuk e tërheq pensionin, do të fshihet nga regjistri i përfituesve të pensioneve të parakohshëm.

(3) Nëse përfituesi i pensionit i cili është fshire nga regjistri, për shkak te mos tërheqjes se pensionit për 3 muaj, përsëri kërkon te jete përfitues i këtij pensioni, ai duhet te ju nënshtrohet te gjitha procedurave te përcaktuara më këtë Udhëzim Administrativ,

Neni 9

Autorizimi për tërheqjen e pensionit te parakohshëm

Përfituesit të cilët nuk mundën ta tërheqin personalisht pensionin për arsye të gjendjes së rëndë shëndetësore, pensioni i tyre mund të tërhiqet nga i autorizuari i tyre, vetëm pasi të vërtetohet sëmundja nga institucioni kompetent mjekësor.

Neni 10

Pamundësia e trashëgimit të pensioneve të parakohshme

Pensioni i parakohshëm i punëtorëve të kompleksit “Trepça”, është vullnetar dhe punëtori e fiton këtë të drejtë vetëm nëse aplikon.

Pensioni i parakohshëm është personal, që do të thotë se pas vdekjes së përfituesit të pensionit e drejta në pension nuk kalon në anëtarët e familjes së tij.

Neni 11

Kushtet dhe kriteret shtesë për përfitimin e pensionit të parakohshëm

Për punëtorët për të cilët ekziston dyshimi se gjenden jashtë vendit, përveç letërnjoftimit duhet t’ju kërkohej edhe deklarata e vërtetuar në Gjykatë me të cilën ata vërtetojnë se janë me vendqëndrim të përhershëm në Kosovë.

Neni 12

Dokumentet e tjera valide për këtë çështje

Krahas këtij Udhëzimi Administrativ për këtë çështje, dokumente bashkëvepruese dhe valide do të jenë edhe Memorandumi i Mirëkuptimit i lidhur ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Menaxhmentit “Trepça” nën administrimin e UNMIK-ut dhe vendimet e Qeverisë së Kosovës.

Neni 13
Shfuqizimi i akteve nënligjore

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, shfuqizohet U.A nr.02/2006 dhe U.A nr.03/2003 si dhe çdo dispozitë tjetër e cila është në kundërshtim me këtë Udhëzim Administrativ.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ do të hyjë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së

Prishtinë, Nëntor 2007

Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj
